

## 1-22 gusht, mbi 147 mijë udhëtarë me tragete nga Durrësi



Mbi 147 mijë udhëtarë vendas dhe të huaj kanë shfrytëzuar lundrimin me tragete përmes Durrësit gjatë 22 ditëve të para të muajit gusht.

Sipas statistikave të sektorit të trageteve, ditët e fundit numri I udhëtarëve që nisen drejt porteve të Barit, Ankonës dhe Triestes (Itali) është disa herë më i lartë se sa I atyre që mbërrijnë. Por numri i përgjithshëm I nisjeve dhe mbërritjeve deri tani është thuajse i njëjtë.

Që nga fillimi i gushtit në sheshin e trageteve kanë mbërritur 76.841 udhëtarë me 20.183 autovetura gjithsej, ndërsa numri I atyre që janë nisur drejt porteve të Italisë ka arritur në 70.748 udhëtarë me 16.181 autovetura.

Që nga fillimi I muajit korrik kur nisi fluksi i mbërritjes së bashkëatdhetarëve që kaluan pushimet pranë familjeve të tyre në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, në sheshin e trageteve kanë funksionuar 31 sportele të kontrollit kufitar dhe doganor, duke shkurtuar ndjeshëm kohën e përpunimit të udhëtarëve dhe duke lehtësuar lëvizjen e udhëtarëve në këmbë ose me automjete.

Gjatë muajit gusht ka vijuar normalisht edhe transporti I mallrave me tragete. Sipas të njëjtave statistika brenda 22 ditësh tragetet kanë transportuar 2796 kamjonë dhe trajlera, përveç udhëtarëve dhe autoveturave.

**Mbi 543 mijë udhëtarë vendas dhe të huaj kanë preferuar udhëtimin me tragete që nga fillimi i vitit 2011.**

